



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 15, datë 18.01.2012

MBI

SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË VLERËSUESIT TË PAVARUR
Z. ASQERI XHANI

Në bazë dhe për zbatim të nenit 146 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare pasi mori në shqyrtim ankimin e vlerësuesit të pavarur Z. Asqeri Xhani, me propozim të Departamentit të Çështjeve Ligjore,

KONSTATOI SE:

Autoriteti ka licencuar si vlerësues dëmsh në sigurime Z. Asqeri Xhani me licencën nr. 11, datë 02.10.2008.

Me Vendimin e Bordit nr. 164, datë 13.12.2011, është marrë masa administrative e tërheqjes së licencës. Ky vendim është marrë në përputhje me procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Z. Asqeri Xhani ka depozituar në Autoritet ankimin administrativ ndaj këtij vendimi.

Pretendimet e parashtruara nga Z. Asqeri Xhani në ankimin administrativ, janë të pambështetura në ligj dhe në fakte, për arsye se në të gjitha konstatimet, për aktet e vlerësimit të kryera si rrjedhojë e angazhimit të tij nga Gjykata në cilësinë e ekspertit, ka rezultuar se Z. Asqeri Xhani ka shkelur legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Bordit nr. 164, datë 13.12.2011 “Për marrjen e masës administrative ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime Asqeri Xhani” dhe rrëzimin e ankimit të Z. Asqeri Xhani.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

NËNKRYETAR
Enkeleda SHEHI